



BULETINI

PRILL 2025



DY KAMPE RINORE TË MBAJTURA NË PRILL


Në kuadër ciklit të ri të kampeve të të rinjve të nisur në shkurt 2025, dy kampe treditore u mbajtën me sukses në prill: i pari në Graçanicë nga 11 deri më 13 prill dhe i dyti në Bogë afër Pejës, nga 25 deri më 27 prill.

Qëllimi i këtyre kampeve, të organizuara në kuadër të programit YESS – Fuqizimi i të rinjve përmes shkollave dhe shoqërive gjithëpërfshirëse, është fuqizimi i të rinjve përmes dialogut ndërkulturor, promovimit të mësimin të përbashkët dhe përdorimit të dy gjuhëve zyrtare – serbe dhe shqipe.

Programi përfshinte një sërë punëtorish interaktive dhe krijuese, duke inkurajuar pjesëmarrësit të shkëmbejnë përvoja dhe të njihen me njëri-tjetrin në një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës.



Në kaudër të projektit gjithashtu u vazhdua fushatën mediatike duke promovuar histori pozitive nga kampet rinore. Një artikull Op-Ed nga një prej pjesëmarrësve u botua, i titulluar "Zbulimi i Unitetit përmes Përvojave në Kampet Rinore", në të cilin autori përshkruan rëndësinë e lidhjeve ndërkulturore, të mësuarit përmes lojës dhe thyerjen e stereotipeve ndërmjet të rinjve.



Programi zbatohet në kuadër të projektit "Të rinjtë e fuqizuar përmes shkollave dhe shoqërive gjithëpërfshirëse (YESS)," financuar nga Fondi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për ndërtimin e paqes dhe zbatuar nga UNICEF dhe IOM Kosovë.

PUNËTORIA E MBAJTUR NË KUADËR TË FORUMIT TË DIALOGUT TË AVOKATIT TË POPULLIT DHE OSHC-VE



Nga data 25 deri më 27 prill 2025, në Durrës u mbajt punëtorja në kuadër të Forumit të Dialogut ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile, organizuar nga ACDC.

Gjatë punëtorisë u prezantua raporti vjetor mbi aktivitetet e Forumit dhe pjesëmarrësit përcaktuan synimet dhe drejtimit për periudhën 2025-2026. Vëmendje e veçantë i'u kushtua forcimit të rolit të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet.



TRYEZË DISKUTIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË PRIZREN



Një tryezë diskutimi e mbajtur më 11 prill në Prizren mbledhi së bashku përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile për të prezantuar një raport mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në rajon.

Pjesëmarrësit ishin Avokati i Popullit i Kosovës z. Naim Çelaj, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga rajoni i Prizrenit dhe Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC Dushan Radaković. Diskutimi kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe OSHC-ve, ofrimin e hapësirës për shkëmbim të opinioneve për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe mundësimin e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët për problemet në komunitetet e tyre.

OLD SCHOOL TRIO PERFORMON NË KUADËR TË PROJEKTIT "KANVASI KULTUROR".

Për të përmirësuar qasjen në përmbajtje kulturore dhe për të mbështetur artistët e rinj, ACDC vazhdon aktivitetet në kuadër të projektit Kanvasi Kulturor në veri të Kosovës.




Një koncert i grupit Old School Trio nga Shtërpca u mbajt në Qendrën Kulturore Private "Aquarius" në Mitrovicën e Veriut më 4 prill. Ngjarja mbledhi së bashku pjesëmarrës të shumtë të cilët shijuan performancën energjike dhe hitet e njohura pop-rock.



Mbështetja e aktiviteteve të tilla mbetet pjesë e përpjekjeve tona për të forcuar dialogun ndërkulturor, për të krijuar hapësirë për histori të reja artistike dhe për të lidhur të rinjtë përmes krijimtarisë.

ACDC MBËSHTET LËSHIMIN E ALBUMIT TË GRUPIT "SOMETHING WENT WRONG".

Në kuadër të të njëjtit projekt, ACDC gjithashtu mbështeti publikimin e albumit debutues të grupit Something Went Wrong, të mbajtur në Mitrovicën e Veriut. Mbështetja për këtë ngjarje është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të ofruar platforma për muzikantët e rinj që të shprehen dhe të fitojnë njohje.



Si pjesë e kësaj nisme, u botua një artikull nga Ilda Krama – "Kur tingulli bëhet urë – SWW dhe arti që lidh botët" – duke theksuar procesin krijues që qëndron pas albumit dhe rolin e artit në lidhjen e komuniteteve. I gjithë albumi, i përbërë nga pesë këngë alternative dhe elektro-pop, është i disponueshëm në [YouTube](#). 



Ilda Krama, SWW



PREZANTOHET ANALIZA MBI PËRDORIMIN E GJUHËS SERBE NË INSTITUCIONET LOKALE

Më 17 prill, ACDC organizoi konferencën për prezantimin e analizës “Zëri i gjuhës: Monitorimi i përdorimit të gjuhës serbe në institucionet lokale”. Pjesëmarrësit diskutuan gjendjen aktuale të të drejtave gjuhësore të komuniteteve joshumicë në veri të Kosovës, veçanërisht çështje të tilla si përkthimet joadekuate, mungesa e informacionit dygjuhësh dhe neglizhenca institucionale.



PËRDORIMI I GJUHËS SERBE NË INSTITUCIONET LOKALE NË VERI TË KOSOVËS



Dokumenti "Zëri i gjuhës" analizon se si komunitetet e veriut të Kosovës i përmbushin obligimet ligjore në lidhje me përdorimin e gjuhës serbe – përmes përkthimeve, dokumenteve dygjuhëshe dhe komunikimit me nëpunësit civil. Analiza është e disponueshme në faqen e internetit të OJQ ACDC në serbisht, shqip dhe anglisht.

SRB

ENG

ALB

MBRËMJA MUZIKORE QË KREMTON UNITETIN DHE DIVERSITETIN KULTUROR

Në Mitrovicën e Jugut, më 27 prill 2025, u organizua një mbrëmje muzikore nga OJQ REC – Reconciliation Empowering Communities, në kuadër të projekti të zbatuar në partneritet me OJQ ACDC dhe të mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë. Në një skenë të hapur dhe para një publiku të gjerë, performuan grupi Jimmy Mustafa Band dhe dyshja Anisa & Erhan, duke ndërthurur stile të ndryshme muzikore dhe identitete kulturore



OJQ ACDC NË NGJARJE

Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radaković, mori pjesë më 3 prill 2025, në një panel diskutimi rajonal në Prishtinë, të organizuar nga Iniciativa e Rinisë për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS) dhe Institucioni i Avokatit të Popullit. Diskutimi trajtoi sfidat ligjore dhe politike me të cilat përballen mbrojtësit e të drejtave të njeriut – duke përfshirë gjuhën e urrejtjes, sulmet në internet, mbikëqyrjen dixhitale dhe paditë SLAPP.



Menaxheri i projektit në OJQ ACDC Stefan Kalaba mori pjesë në ngjarje rajonale treditore të organizuar nga rrjeti SELDI, të titulluar “Fuqizimi i ndryshimit: Avokimi kundër korrupsionit dhe ndikimi i politikave”, të mbajtur nga 14–16 prill në Maqedoninë e Veriut. Mbi 30 organizata të shoqërisë civile nga rajoni morën pjesë në trajnime, panele dhe shkëmbime të praktikave më të mira në përpjekjet kundër korrupsionit.



ACDC NË MEDIA

Ines Aljović Mihajlović, Zyrtare e Programit në OJQ ACDC, u shfaq në “Radio Mitrovica Sever”, ku diskutoi çështjen e pezullimit të pagesave të ndihmës së fëmijëve për familjet në komunitetet serbe në Kosovë. OJQ ACDC ka mbështetur një grup joformal prindërisht të cilët kanë nisur një iniciativë për zgjidhjen e këtij problemi, duke theksuar rëndësinë e përgjegjësisë institucionale ndaj të gjithë qytetarëve.



Menaxherja e projektit në OJQ ACDC Andrea Todić, mori pjesë në trajnim për gazetarë të organizuar nga OJQ Communication for Social Development, në bashkëpunim me IOM-in dhe Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve. Trajnimi u mbajt në Ohër nga 27 deri më 29 Prill dhe mbuloi tema si të drejtat gjuhësore, raportimin etik dhe rolin e gjuhës në ruajtjen e identitetit. Morën pjesë gazetarë nga komunitete të ndryshme anembanë Kosovës.



KONTAKT



office@acdc-kosovo.org



[@acdc.kosovo](https://www.instagram.com/acdc.kosovo)



www.facebook.com/Ngoacdc



[@ngo_acdc](https://twitter.com/ngo_acdc)



www.acdc-kosovo.org

